

VENDIM
Nr. 639, datë 27.8.2026

**PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË 89,652% TË AKSIONEVE TË
SHOQËRISË “DUHAN CIGARE” SHA, NË LIKUIDIM, SHKODËR, NGA
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT TEK BASHKIA SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar; të paragrafit të tretë, të nenit 4, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë së 89,652% të aksioneve të shoqërisë “Duhan Cigare” sh.a., në likuidim, Shkodër, nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit tek Bashkia Shkodër, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi